



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

Nr. 2046/₁₆ prot.

Tiranë, më 14.05.2024

Shtyrje afati të shpalljes së thirrjes për shprehje interesi për hartues të programit orientues dhe të fondit të pyetjeve për profesionin e rregulluar të mësuesit, profili Ekonomi

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall thirrjen për shprehje interesi për hartues të programit orientues dhe të fondit të pyetjeve për profesionin e rregulluar të mësuesit, profili Ekonomi.

Kriteret:

- Ka të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në IAL si personel akademik me kohë të plotë;
- Ka së paku gradën shkencore "Doktor";
- Përbën avantazh të ketë trajnime në metodikën e hartimit të pyetjeve.

Dokumentacioni:

- Formulari i aplikimit sipas formatit të publikuar nga QSHA;
- Jetëshkrimi;
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të dokumentacionit që provon zotërimin e gradës shkencore "Doktor".

Procedura:

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me rrugë postare në adresën e mëposhtme:

*Qendra e Shërbimeve Arsimore
Blv. Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë*

Afati i dorëzimit të dokumentacionit:

Brenda datës 20.05.2024

**Formulari i aplikimit gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore
www.qsha.gov.al*

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurora Balliu

